



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-25-1663-1-3-6/C1035
14 Nr. 387/25
Dt. 23.05.2025

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i ZPP-së** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) dhe
2. **" INFINITT " SH.P.K., Dëshmorët e Kombit, PRISHTINË, emri i tregtar/" INFINITT " SH.P.K., emri biznesit, me seli në Prishtinë, me ARBK : 601614177, të cilën e përfaqëson z. Astrit Uka, në tekstin e mëtejme: FURNIZUESI,**

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizimi me projektor dhe mbajtës për projektor.,** me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	16	6	3	1	3	6
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	0	6	1	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizimi me projektor dhe mbajtës për projektor.,** ashtu sikurse është specifikuar ne Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme pjesë e Dosjes së Tenderit.
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: jo më gjatë se 30 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës.
- 1.3 Vendi i dërgimit do të jetë : **Vendi kryesor i dorëzimit ose i realizimit ; në shkolla sipas planit të Shpërndarjes.**
- 1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3,787.80€**; [*tremijëeshtatqindetëdhjeteshtatë/80*] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pasi që Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit i Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim pranim- **Furnizimi me projektor dhe mbajtës për projektor.**, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se **Furnizimi me projektor dhe mbajtës për projektor.** është dorëzuar – pranuar nga A.K. , si në aspektin teknik dhe në aspektin cilësor. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit/Furnizuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimin dhe / ose shërbimin e përfunduar.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimit dhe / ose shërbimit është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisa e dorëzuar duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit.

Furnizuesi duhet të ofroj garanci për pjesët mekanike, elektrike dhe pajisje elektronike - Minimum 12 muaj. Dokumenti Deklarat garantuese.

Neni 8

Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimit dhe / ose shërbimit të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9

Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10

Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11

Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12

Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.




3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:

" INFINITT " SH.P.K..

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e
Vushtrrisë

Emri:	Astrit Uka	Emri:	Ilmi Azemi
Pozita:	Drejtor ekzekutiv	Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	22.05.2025	Data:	22.05.2025
Vula:		Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: VU644-25-1663-1-3-6/C1035

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	10%(dhjetë përqindë) e vlerës së përgjithshme të kontratës. Dokumenti - Polisa e sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi	10.1	<i>[Specifikoni kërkesat specifike të sigurimit]</i>
Programi i ekzekutimit	11	<i>[Specifikoni nëse kërkohet programi i ekzekutimit, me data dhe afate kohore, dhe kërkesat në lidhje me ndonjë manual]</i>
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	ddp
Patentat dhe licencat	13.1	Cilësia e furnizimeve duhet të jete në përputhshmëri të plote me Specifikat teknike të kërkuara në Aneksin 1- Specifikat teknike të detyrueshme dhe ofertën e Furnizuesit
Cilësia e furnizimeve	18.2	Menaxheri i Projektit: do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës. Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në përputhje me Nenin 19 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuara në Nenin 2.2 të Kontratës
Inspektimi dhe testimi	19.2	Menaxheri i Projektit: do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës. Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në përputhje me Nenin 19 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuara në Nenin 2.2 të Kontratës
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për furnizimet e dorezuara vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues. Per pages është i nevojshëm pranimi i mallit nga ana e menaxherit të kontratës dhe komisionit për pranim të mallit. Pagesa do të kryhet Brenda afatit me të shkurter kohor por jo me gjate se 30 dite pas dorezimit / pranimit dhe protokolimit të fatures

		nga zyrtari pergjegjes i Autoritetit Kontraktues
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të pakëtohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre. Dërgesa: Dërgesat do të bëhet brenda 40 ditëve pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Autoritetit Kontraktues. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet e garancionit	24.1	Furnizuesi duhet të ofroj garanci për pjesët mekanike, elektrike dhe pajisje elektronike - Minimum 12 muaj. Dokumenti Deklarat garantuese.
	24.5	<i>[Specifikoni ndonjë obligim shtesë sipas garancisë]</i>
Shërbimet pas shitjes	25.1	<i>[Jepni detajet e shërbimit pas shitjes që Furnizuesi duhet të siguroj dhe përcaktoj raportin e sigurisë së ekzekutimit të caktuar për këtë aktivitet]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<i>Konform nenit 31 të kushteve të përgjithshme të kontratës.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë.

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%-8%-apo-18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore.

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
I									
1	Mbajtës për projektor në tavan, montues universal, me distancë nga tavan të paku 20 cm i cili lejon përtëritje deri 15 shkallë dhe rrotullim deri 180 shkallë.	copë	9	12.29	18.00	14.50	110.59	19.91	130.50
2	10 Meter kablo HDMI për projektor	copë	9	6.61	18.00	7.80	59.49	10.71	70.20
3	10 Meter Kablo e rrymës elektrike, standard tri polëshe për projektor me gjithë spin (mashkull)	copë	9	5.08	18.00	6.00	45.76	8.24	54.00
4	Kanale plastike për vendosjen e kabllave	metër	66	0.64	18.00	0.75	41.95	7.55	49.50
5	Konvertues nga HDMI në VGA	copë	9	4.07	18.00	4.80	36.61	6.59	43.20
6	Resolution Native WXGA (1280 x 800) Aspect Ratio 16:10 Color/White Brightness: 3,000/3,000 lumens Lamp Life (Normal Mode) Up to 6,000 hours ECO Mode Up to 12,000 hours Throw Ratio Range 1.27 – 1.71 Color Reproduction Up to 16.8 million colors Keystone Correction (Vertical) and (Manual Horizontal) ± 30 degrees Speaker 5 W Interface: HDMI , USB- Type A , Projection Method Front/rear/ceiling mount Remote Control	copë	12	242.97	18.00	286.70	2,915.59	524.81	3,440.40
NËTOTALI I:								577.80	3,787.80

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	INFINITT SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQESUESIT TE OE:	Astrit Uka
NËNSHKRIMI:	
DATA:	20.03.2025.
VULA:	

Numri i prokurimit: VU644-22-1466-1-3-6 apo nr. i brendshem: VU644-25-006-136 Titulli: Furnizimi me projektor dhe mbajtës për projektorë,

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Furnizim me projektorë dhe mbajtësve te projektorëve 2025- SPECIFIKACIONI

Sasia	Njesia matëse	Përshkrimi
9	copë	Mbajtse për projektor në tavan, montues universal, me distancë nga tavani së paku 20 cm i cili lejon pjerrtësi deri 15 shkallë dhe rrotullim deri 180 shkallë.
9	copë	10 Meter kablo HDMI per projektor
9	copë	10 Meter Kablo e rrymës elektrike, standard tri polëshe për projektor me gjithë spin (mashkull)
66	M	Kanale plastike per vendosjen e kabllave
9	cope	Konvertues nga HDMI në VGA
		Montimi Përfshihet ne kete Çmim.
12	cope	Projektor
		Resolution Native WXGA (1280 x 800)
		Aspect Ratio 16:10
		Color/White Brightness: 3,000/3,000 lumens
		Lamp Life (Normal Mode) Up to 6,000 hours
		ECO Mode Up to 12,000 hours
		Throw Ratio Range 1.27 – 1.71
		Color Reproduction Up to 16.8 million colors
		Keystone Correction (Vertical) and (Manual Horizontal) ± 30 degrees
		Speaker 5 W
		Interface: HDMI , USB- Type A ,
		Projection Method Front/rear/ceiling mount
		Remote Control
		Garancioni 1 vit

